



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e Interpretimit

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë mësimore në klasë, 15 leksione dhe 15 seminare
Viti / Semestri: Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave ” Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T’u japë studentëve njohuri teorike dhe praktike mbi rolin e interpretit të konferencës si ndërmjetës gjuhësor dhe kulturor në kontekste profesionale dhe ndërkombëtare. Të zhvillojë ndërgjegjësimin dhe përgatitjen për sfidat dhe etikën e profesionit të interpretimit sipas standardeve të organizatave ndërkombëtare. Të ofrojë një bazë solide për kalimin gradual nga përgatitja akademike drejt praktikës së mirëfilltë profesionale në interpretim.

Objektivat specifike lëndore:

1. T’i aftësojë studentët në zgjidhjen e problemeve të zakonshme gjatë interpretimit përmes ushtrimeve praktike dhe analizës së videove autentike.
2. T’u ofrojë studentëve njohuri për historinë dhe zhvillimet bashkëkohore të interpretimit të konferencës, përfshirë aspektet teorike dhe teknike.
3. Të nxisë aftësitë e vlerësimit kritik të performancës individuale dhe kolektive në interpretim, përfshirë reagimin ndaj stresit dhe menaxhimin e situatave të vështira.

Rezultatet e pritshme :

1. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe shpjegojnë rolin dhe përgjegjësitë e interpretit të konferencës në mjedise reale profesionale.
2. Do të demonstrojnë aftësi praktike në interpretimin simultan dhe konsektiv në situata të ndryshme, duke respektuar normat etike dhe profesionale të fushës.
3. Do të jenë të aftë të analizojnë, vetëvlerësojnë dhe përmirësojnë performancën e tyre në kabinë, si edhe të menaxhojnë stresin dhe sfidat që lidhen me punën në kohë reale.